



ГРАД СКОПЈЕ - QYTETI I SHKUPIT

Бр. Nr.

08-9290/4

07. 08. 2026 20

СКОПЈЕ - SHKUP

QYTETI I SHKUPIT
SEKTORI PËR ZHVILLIM LOKAL EKONOMIK
SHKUP

**BASHKËNGJITJE E APLIKIMIT
PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR REALIZIMIN E FESTIVALIT
“FESTIVALI XHAZIT SHKUP”**

**PËRMBAJTJA DHE KRITERET QË DUHET TË PLOTËSOHEN NGA ANA E
REALIZUESIT TË MANIFESTIMIT: “FESTIVALI I XHAZIT SHKUP”**

1. PËRMBAJTJA E MANIFESTIMIT

Manifestimi pritet të jetë destinacion ku do të prezantohet muzika botërore, argëtim ku do të marrin pjesë instrumentistë, grupe muzikore dhe interpretues solo nga e gjithë bota, të cilët do të promovojnë kapacitetin e tyre vokal dhe muzikor para publikut vendas, të njohur në skenën botërore të xhazit. Ky aktivitet pritet të promovojë turizmin në qytetin e Shkupit dhe ta vendosë atë në hartën e metropoleve evropiane dhe botërore ku mbahen festivale të tilla.

- Pritet të ftohen grupe të njohura vendase dhe të huaja nga Qyteti dhe rajoni, të njohura në skenën e xhazit;
- Pritet të ofrohet listë bashkëpunimi dhe ftesa për pjesëmarrje për shoqata ose sipërmarrës të vegjël ose startup-e që mund të promovojnë prodhime tradicionale maqedonase me simbolikën e Qytetit;
- Të ofrohet projekt i shkurtër për festivalin kushtuar muzikës xhaz për audiencën e gjerë;
- Të sigurohen stenda/tenda përfaqësuese për prezantimin e pijeve freskuese;
- Të organizohet ceremoni hapjeje e festivalit nga kryetari i Qytetit të Shkupit;
- Ftesa për prezantues të tjerë të punimeve artizanale dhe shembujve muzikorë që lidhen me muzikën xhaz sipas zgjedhjes së realizuesit të Projektit dhe sigurimi i shitjes së tyre;
- Shënimi i vendndodhjes me materiale promovuese dhe organizimi i rikthimit të tij në gjendjen para përdorimit.;

KUSHTE PËR REALIZIMIN E MANIFESTIMIT

- Përvojë në organizimin dhe koordinimin e manifestimeve dhe festivaleve të karakterit të hapur dhe të mbyllur, minimum pesë vite;
- Koha e mbajtjes - në konsultim me Qytetin e Shkupit;
- Vendndodhja: Vendndodhje atraktive në konsultim me Qytetin e Shkupit;
- Infrastruktura: në marrëveshje me Qytetin e Shkupit;
 - shënimi i zonës ku do të zhvillohet festivali me materiale promovuese,
 - sigurimi dhe lidhja e instalimeve elektrike,

- sigurimi i zërit dhe ndriçimit të përshtatshëm sipas vendndodhjes dhe ambienteve,
- sigurimi dhe lidhja e instalimeve hidraulike,
- organizatori i ngjarjes, në bashkëpunim me Sektorin për ZHLE dhe Sektorin e punëve komunale të Qytetit të Shkupit, do të sigurojë pastrimin e vendit ku do të mbahet eventit para dhe pas përfundimit të tij (në bashkëpunim me NP "Higjiena Komunale" të Qytetit të Shkupit),
- sigurimi i pajisjeve sanitare mobile për të ruajtur higjienën e eventit (kontratë me kompani adekuate), numri i tualeteve mobile (toi-fori) sipas numrit të mysafirëve të pritur nëse eventit është në ambient të hapur,
- tenda përfaqësuese-shitjeje, stenda, shtëpiza, tavolina dhe stola për vizitorët,
- sigurimi i animacionit aktiv të përshtatshëm të eventit sipas programit të eventit (skicë e shkurtër e projektit me ide),
- posedimi i pajisjeve të përshtatshme për logjistikën e festivalit,
- sigurimi i pajisjeve muzikore të përshtatshme për të përmbushur programin muzikor të festivalit (kontratë ose parakontratë me kompani për pajisjet adekuate),
- skenë e madhe ku do të prezantohen grupe muzikore vendase dhe të huaja. Logoja e Qytetit të Shkupit duhet të vendoset në vend të dukshëm në skenë, si dhe në hyrje të lokacionit,
- elementë të tjerë të infrastrukturës që do të propozohen nga realizuesit dhe ekspozuesit;
- Informimi i shërbimeve të sigurisë në lidhje me eventin (në marrëveshje me Qytetin e Shkupit dhe MPB-në);
- Angazhimi i një agjencie për të ruajtur rendin publik në vendndodhjen në qytet;
- Përgatitja e materialit përfaqësues dhe promovues me logon e Qytetit të Shkupit;
- Mbulimi mediatik i festivalit, si nga media elektronike ashtu edhe nga ajo e shkruar (një javë para eventit, konferencë për shtyp për të informuar publikun, pjesëmarrje në emision televiziv, informacion që do të ndahet në mediet sociale, stacionet radiofonike, gazetat elektronike);
- Sigurimi i draft - propozimit grafik të përshtatshëm për materialin promovues të festivalit (poster, fletushkë, broshurë, pllakate, fletë falënderimi);
- Mbajtja e evidencës së veçantë të dokumenteve mbi të ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me organizimin e festivalit, i cili do t'i dorëzohet qytetit pas përfundimit të festivalit.

2. KRITERE PËR DHËNIEN E KONTRATËS SIPAS THIRRJES PUBLIKE

Si mbajtës i kontratës sipas Thirrjes publike do të zgjidhet ai aplikim që vlerësohet si më i volitshmi nga shumica e pikëve për secilin element në veçanti.

Kritere	Numri maksimal i pikëve
1. Organizimi i strukturës organizative dhe burimet	30
1.1 Aplikanti ka strukturën e nevojshme organizative dhe burimet njerëzore për realizimin e manifestimit (të punësuar, vullnetarë aktivë, persona të angazhuar me honorar etj)	10
1.2 Aplikanti disponon logjistikë (zyrë dhe pajisje teknike për realizimin e manifestimit)	10
1.3 Dukshmëria e aplikantit në internet	10
2. Financimi i propozim projektit për realizimin e manifestimit	30
2.1 Plan financiar i detajuar për mjetet e nevojshme për realizimin e manifestimit	10
2.2 Aplikanti siguron përqindje të pjesëmarrjes së tij në realizimin e projektit.	10

2.3 Plan financiar real (përshkrimi i shpenzimeve sipas kategorive të pozicioneve korrespondon me çmimet e tregut)	10
3. Cilësia e propozim projektit për realizimin e manifestimit	40
3.1 Objektiv i përgjithshëm i qartë dhe i përcaktuar në mënyrë adekuate i propozim projektit që do të kontribuojë në realizimin e prioriteteve të dhëna nga Programi i aktiviteteve në fushën e zhvillimit lokal ekonomik të Qytetit të Shkupit.	10
3.2. Zgjidhje cilësore dhe inovative të ofruara në projekt propozim	10
3.3 Sigurimi i përfshirjes së institucioneve dhe organizatave të tjera	10*
3.4 Propozim projekti për zbatimin e manifestimit është i qartë dhe i realizueshëm.	10

Çdo fushë e kritereve të veçanta do të vlerësohet me 1 pikë, 5 pikë ose 10 pikë, me kuptimin e mëposhtëm: 1-jo, 5-pjesërisht dhe 10-po.

*Vërejtje:

- Në propozimin e projektit të paraqitur, duhet të depozitohet listë e grupeve muzikore që do të marrin pjesë në festival;
- Të depozitohet pëlqim i nënshkruar për aplikimin e interesit për pjesëmarrje në festival, për secilin pjesëmarrës dhe objekt ushqimi veçmas;
- Të deklarohet përvoja e aplikantit në organizimin e festivaleve të dedikuara veçanërisht muzikës xhaz (organizimi i festivaleve të llojit të ngjashëm për sa i përket masivitetit të festivaleve, kohëzgjatjes, etj., do të merret parasysh gjatë vlerësimit);
- Në propozim-projektin e depozituar duhet të dorëzohet program argëtimi (emra muzikorë, etj.)
- Të depozitohen biografitë e organizatorëve të festivalit.

Përgatiti, Rukije Asani
Kontrolloi, Marina Misajleski
Miratoi, Marina Misajleski



Kryetari i Qytetit të Shkupit
Orce Gjorgjievski